

V E N D I M
Nr.334 datë 9.7.1993

PËR MIRATIMIN E PLANIT KONTABËL TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të ligjit 7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit kontabel të përgjithshëm me cilësinë e sistemit kontabel të përgjithshëm, parashikuar në shkronjen a të nenit 3 të ligjit "Për Kontabilitetin".

2. Me rezervën e përshtatjeve të përligjura nga veçoritë e veprimtarisë, dispozitat e planit kontabel të përgjithshëm zbatohen:

a. nga ndërmarrjet e industrisë, së ndërtimit, të bujqësisë dhe të prodhimeve të tjera.

b. nga ndërmarrjet e tregtisë me shumicë e pakicë, duke përfshirë dhe ato të ushqimit social e të hotelërisë.

c. nga ndërmarrjet e transportit, të telekomunikacionit dhe të shërbimeve të tjera të natyrës mall (për treg) qofshin këto të karakterit material apo jomaterial.

ç. nga shoqëritë e profesioneve të lira, të cilat i vendosin llogaritë e tyre me autoritetet tatimore mbi bazën e rezultatit.

d. nga institucionet ose organizatat politike, fetare, shoqërore, profesionale, kulturore e sportive që ushtrojnë veprimtari ekonomike, duke përfshirë dhe fondacionet.

3. Përshtatjet e dispozitave të këtij plani kontabel me veçoritë e subjekteve të caktuara në pikën 2 të këtij vendimi do të kryhen nëpërmjet planeve kontabel të veçanta, siç është parashikuar në shkronjat a dhe b të nenit 4 të ligjit "Për Kontabilitetin".

4. Dispozitat e planit kontabel të përgjithshëm përbëjnë kuadrin bazë të referimit për përgatitjen e planeve kontabel të tjera, të parashikuara në shkronjën b të nenit 3 të ligjit "Për kontabilitetin".

5. Subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi të marrin masat për ristrukturimin e kontabilitetit të tyre në pajtim me këtë plan kontabel të përgjithshëm, zbatimi i të cilit nis me ushtrimin kontabel që çeleet më 1 janar 1994.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi